

NJOFTIM
Nr. 3450, datë 17.2.2023

**PËR SHITJE ME ANKAND TË PRONËS SHTETËRORE NË ADMINISTRIM
TË SHOQËRISË “KAMBERI” SHPK**

Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 926, datë 29.12.2014, “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet, dhe për procedurën e shitjes”, të ndryshuar, kreu III, shpallet për shitje me VAM fillestar, si më poshtë:

1. Në pronësi të shoqërisë “Kamberi” administrim sh.p.k.

Nr.	Emërtimi i objektit	Vendndodhja	Vlera fillestare e ankandit në lek	Zhvillimi i ankandit		
				Data	Ora	Vendi
1	Motogjenerator, marka TROGENO-TORINO, e tipit MV nr. 118	Tiranë	70 000	8.3.2023	12:00	DDPP

Çdo person fizik apo juridik i interesuar për blerje me ankand duhet të paraqesë në vendin, datën dhe orën e njoftuar pranë komisionit të ankandit, dokumentacionin si më poshtë:

1. Kërkesë me shkrim për blerjen e objektit apo të ndërmarrjes e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

2. Mandatpagesën apo garancinë bankare në original, që vërteton derdhjen apo ngurtësimin e 20% të vlerës së fillimit të ankandit, në lek, për llogari të Shoqërive Huamarrëse në Administrim.

3. Dokument identifikimi (pasaportë biometrike ose letërnjoftim).

Shënim. Pjesëmarrësit në ankand, i cili tërhiqet nga ankandi pa dhënë asnjë ofertë për vlerën e objektit të shpallur për shitje, nuk i kthehet 20% e vlerës fillestare, të ngurtësuar për pjesëmarrje në ankand.

Mandatpagesa apo garancia bankare duhet të bëhet detyrimsht brenda afatit të pranimi të kërkesave për pjesëmarrje në ankand. Mandatpagesa apo garancia bankare mund të bëhen pranë çdo banke të nivelit të dytë në llogaritë respektive të hapura për Shoqëritë Huamarrëse në Administrim, pasi të keni tërhequr pranë Shoqërive Huamarrëse në Administrim faturën për arkëtim të plotësuar dhe të nënshkruar nga përfaqësuesi i institucionit.

Këto informacione gjenden edhe në faqen e internetit të Ministrisë së Financave: www.financa.gov.al.